

Monitorimi i Përdorimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Ky raport u realizua me mbështetjen e Popullit Amerikan përmes Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II (MCCA2), i cili administrohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). *Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri* mban përgjegjësi të plotë për brendinë e këtij raporti, i cili nuk përfaqëson detyrimisht pikëpamjet e Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit, USAID-it, apo të qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përgatitur nga Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri

Përgatitur për Programin Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II

Shtator 2010

Përmbajtja

Lista e tabelave dhe grafikëve	4
Shkurtime	5
1. Përmbledhje	6
2. Metodologjia	9
a. Vrojtim i Operatorëve Ekonomikë	
b. Vrojtim i Autoriteteve Kontraktore	
3. Gjetjet nga vrojtimi i Operatorëve Ekonomikë.....	10
4. Gjetjet nga vrojtimi i Autoriteteve Kontraktore.....	28
5. Rekomandimet	35
6. Anekset	36
a. Pyetëtori	

Lista e tabelave dhe grafikët

Tabela 1: Shpërndarja e shembullit sipas rretheve

Grafiku 1: Shpërndarja e shembullit sipas formës ligjore të shoqërisë (n = 300)

Grafiku 2: Shpërndarja e shembullit sipas veprimtarisë kryesore të biznesit (n = 300)

Grafiku 3: Shpërndarja e shembullit sipas numrit të të punësuarve (n = 300)

Grafiku 4: Xhiroja vjetore e kompanisë (n = 300)

Grafiku 5: Përqindja e xhiros vjetore të kompanisë nga prokurimet publike (n = 300)

Grafiku 6: Pjesëmarrja në trajnimet për SPE-në - 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 7: Pjesëmarrja në trajnimet për SPE-në kundrejt nevojës për trajnime të mëtejshme (n = 300)

Grafiku 8: Parametrat e kompjuterave dhe kapaciteti për të përdorur SPE-në (n = 300)

Grafiku 9: Llojet e lidhjes me internetin (n = 296)

Grafiku 10: Shpejtësia e ulët e internetit si një problem – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 11: Ndërprerjet e shumta si një problem – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 12: Vendet ku OE-të përdorin SPE-në – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 13: Procedura e parë e prokurimit dorëzuar përmes SPE-së (n = 300) (përqindja kumulative)

Grafiku 14: Procedura e parë e prokurimit e dorëzuar përmes SPE-së – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 15: Ku i keni paraqitur shumicën e ofertave gjatë vitit 2009? (n=300)

Grafiku 16: Ku i keni paraqitur shumicën e ofertave gjatë vitit 2009? – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 17: Numri i ofertave të paraqitura në vitin 2009 (n = 300)

Grafiku 18: Xhiroja vjetore e kompanisë kundrejt pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit gjatë vitit 2009

Grafiku 19: Aksesi i kompanisë në njoftimet dhe DST-të në krahasim me sistemin e prokurimit në letër – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 20: Pjesëmarrja e OE-ve në procedurat e prokurimit në krahasim me sistemin e prokurimit në letër (n = 300)

Grafiku 21: Xhiroja vjetore e kompanisë kundrejt pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi nëpërmjet SPE-së në krahasim me sistemin e prokurimit në letër (n = 287)

Grafiku 22: Shpeshtësia e kontakteve me specialistët e prokurimit të AK-ve (n = 300)

Grafiku 23: Marrja e informacionit gjatë një procedure prokurimi (përgjigje e shumëfishtë)

Grafiku 24: Gjetja e njoftimit të tenderit dhe DST-ve (n = 300)

Grafiku 25: Sa i lehtë është ngarkimi i dokumentave të ofertës? (n=300)

Grafiku 26: Si e vlerësoni ndërveprimin me SPE-në? (n=300)

Grafiku 27: Pjesëmarrja në trajnime rreth SPE-së në raport me ndërveprimin e përgjithshëm me SPE-në për të kryer një procedurë prokurimi (n = 299)

Grafiku 28: Problemet gjatë përdorimit të SPE-së - përgjigje e shumëfishtë (n = 629)

Grafiku 29: Koha e shpenzuar për të përfunduar një procedurë prokurimi (n = 300)

Grafiku 30: Kostot e burimeve njerëzore dhe financiare për të përfunduar një procedurë prokurimi nëpërmjet SPE-së në krahasim me sistemin e prokurimit në letër (n = 246)

Grafiku 31: Reduktimi i kostove për të përfunduar procedurën e prokurimit përmes SPE-së në krahasim me sistemin e prokurimit në letër – 'në Tiranë' kundrejt 'jo në Tiranë'

Grafiku 32: Niveli i besimit në SPE (n = 300)

Grafiku 33: Besimi i përgjithshëm në SPE - sipas numrit të ofertave të paraqitura

Grafiku 34: Si do t'i vlerësonit këto aspekte të SPE-së? (n=300)

Shkurtime

OE	Operator Ekonomik
AK	Autoritet Kontraktor
SPE	Sistemi i Prokurimit Elektronik
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
PP	Procedurë Prokurimi
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
DST	Dokumentet Standarde të Tenderit
AmCham	Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri
MCCA2	Programi Prag i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II

1. Përmbledhje

Në vitin 2008, Qeveria e Shqipërisë, me mbështetjen e fazës së parë të Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë, zhvilloi dhe vuri në punë Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), një i sistem i bazuar në internet, i cili mundëson menaxhimin elektronik të procedurave të prokurimit publik në vend. SPE menaxhohet nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe mund të përdoret nëpërmjet faqes se internetit të APP-së, www.app.gov.al. Më vonë, po atë vit, një vendim i Këshillit të Ministrave urdhëroi që, duke filluar nga 1 janari 2009, të gjitha institucionet publike duhet t'i realizonin prokurimet vetëm përmes SPE-së, duke eliminuar përdorimin e procedurave të prokurimit në letër.

Me këtë vendim, Shqipëria u bë vendi i parë në botë që zbaton një sistem të prokurimit elektronik për të gjitha prokurimet e sektorit publik mbi pragun e shumë 3000 Euro. Kjo arritje e madhe u vlerësua në nivel ndërkombëtar kur më 23 qershor 2010 APP-ja zuri vendin e dytë (pas Gjermanisë) në Programin e Çmimeve për Shërbime Publike ndër institucionet publike nga 15 vende të botës për arritje të shkëlqyera në shërbimin publik. Ky vlerësim u bë nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara.

Gjatë periudhës shkurt - mars 2010, Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri, me mbështetjen e Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë II (MCCA2), kreu një studim të SPE-së bazuar në përvojën e institucioneve publike që realizojnë prokurime publike (autoritetet kontraktore - AK) dhe të bizneseve që marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik (operatorëve ekonomikë - OE). Më konkretisht, studimi shërbeu për të vlerësuar kostot dhe përfitimet për komunitetin e biznesit, administratën publike, si dhe publikun në përgjithësi, si dhe për të identifikuar çështje, të cilat duhet të adresohen për të përmirësuar efektivitetin dhe përhapjen e sistemit. Studimi u përqëndrua në aksesin në SPE për zyrtarët publikë në nivel të qeverisjes lokale dhe qendrore dhe për bizneset që marrin pjesë në tenderat publikë, si edhe në paanshmërinë, lehtësinë në përdorim, transparencën dhe efikasitetin e sistemit.

Studimi përfshin: (i) një vrojtim në bazë të intervista të drejtpërdrejta me 300 OE në 12 rrethe të Shqipërisë, të cilët patën dorëzuar një ose më shumë oferta në formë elektronike gjatë vitit 2009, (ii) 21 intervista në thellësi me specialistë të prokurimit dhe anëtarë të Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave (KVO) në AK-të në gjashtë rrethe (Tiranë, Shkodër, Fier, Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë), dhe (iii) dy fokus grupe me specialistë të prokurimit ose anëtarë të KVO-ve në disa AK të përzgjedhura.

Gjetjet kryesore nga vrojtimi i OE-ve

- 34% e të intervistuarve filluan ta përdorin SPE-në në vitin 2008.
- Përafërsisht, 28% e të intervistuarve thanë se gjatë vitit 2009 kishin marrë pjesë në trajnime formale mbi përdorimin e SPE-së. 50% e bizneseve të anketuara thanë se kanë nevojë për trajnime të mëtejshme për përdorimin e SPE-së.
- Gati 50% e bizneseve që ndodhen jashtë Tiranës, krahasuar me vetëm 27% e bizneseve në Tiranë thanë se është problem shpejtësia e ulët e internetit në zyrat e tyre.
- Shumica e bizneseve të intervistuar (93%) i përgatisin dhe i dorëzojnë vetë ofertat e tyre përmes internetit, ndërsa rreth 11% e bizneseve të intervistuar që ndodhen jashtë Tiranës, mbështeten në palë të treta për të përfunduar procedurat e prokurimit, pra, në njerëz që e ofrojnë këtë shërbim me pagesë.

- Shumica e bizneseve priren të paraqesin oferta për procedurat e prokurimit të organizuara nga AK-të që ndodhen gjeografikisht pranë vendndodhjes së tyre. Megjithatë, 22% e bizneseve me qendër në Tiranë dhe 15% e atyre jashtë Tiranës, sipas mundësisë, dorëzojnë ofertat e tyre në AK jashtë rajonit ku e kanë vendndodhjen.
- 70% e bizneseve të anketuara thanë se përdorimi i SPE-së e rriti numrin e procedurave të prokurimit në të cilat ata morën pjesë në vitin 2009 në krahasim me pjesëmarrjen e tyre në procedurat e prokurimit në letër.
- 71% e të anketuarve thanë se, gjatë procedurave të prokurimit, ata përdorin më së shumti SPE-në për të kontaktuar specialistët e prokurimit në AK-në përkatëse.
- SPE është mjeti kryesor i komunikimit që OE-të përdorin për të marrë informacion gjatë procedurave të prokurimit. Përqindjet variojnë në varësi të llojit të njoftimit të prokurimit: OE-të e përdorin më së shumti SPE-në për të marrë njoftim për kualifikim (83%) dhe më së pakti për të marrë informacion mbi hapjen e ofertave (56%). OE-të kontaktojnë personalisht me AK-të kur një biznes ka nevojë për informacion mbi hapjen e ofertës (36%) ose ka pyetje apo nevojë për të marrë përgjigje rreth dokumenteve standarde të tenderit (20%).
- 90% e të anketuarve thanë se është “shumë e lehtë” ose “e lehtë” që të gjenden njoftimet për tender në SPE, ndërsa 40% e tyre thanë se ngarkimi i dokumenteve dhe marrja e përgjigjeve nga AK-të ishin “të vështira” ose “shumë të vështira”.
- Përafërsisht 71% e OE-ve që nuk kanë marrë trajnim formal mbi SPE-në, thanë se është “shumë e lehtë” ose “e lehtë” për ta përdorur SPE-në.
- Përafërsisht dy të tretat e të anketuarve thanë se dokumentat e tenderit mund të ngarkohen në sistem në 8 ose më pak orë.
- 82% e bizneseve të intervistuar thanë se kostot financiare dhe njerëzore të pjesëmarrjes së tyre në një procedurë prokurimi janë ulur, në krahasim me shpenzimet e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit në letër.
- 63% e të anketuarve i japin SPE-së vlerësimin “shumë mirë” ose “mirë” për kapacitetin dhe karakteristikat e saj të përgjithshme.

Gjetjet kryesore nga intervistat në thellësi dhe fokus grupet me AK-të

- AK-të thanë se përdorimi i SPE-së ka rritur efikasitetin e procedurave të prokurimit. Nuk ka më vonesa të panevojshme dhe procedurat kryhen në një kohë të shkurtër. Krahasuar me procedurat e prokurimit në letër, komunikimi midis AK-ve dhe OE-ve është shumë më i shpejtë.
- Konkurrenca e ndershme në procedurat e prokurimit tashmë është garantuar në maksimum, sepse ofertuesit potencialë nuk njihen paraprakisht, pasi pjesëmarrja e OE-ve në një procedurë prokurimi është anonime deri në ditën e hapjes së ofertave.
- SPE-ja ka kontribuar në uljen e shpenzimeve për një procedurë prokurimi, duke qenë se rritja e numrit të OE-ve që marrin pjesë në një procedurë prokurimi, rrit konkurrencën. Rritja e konkurrencës sjell uljen e çmimeve të ofertave të dorëzuara. Shumica e të intervistuarve e konsiderojnë këtë si një pririje pozitive, por, për disa prej tyre, kjo ka ulur cilësinë e shërbimeve apo mallrave të ofruara.
- Përfaqësuesit e AK-ve thonë se futja e SPE-së ka rritur transparencën në procedurat e prokurimit, sepse është e pamundur të ndryshohen dokumentet e ofertës brenda SPE-së dhe të gjithë ata që janë të përfshirë në një procedurë prokurimi, janë të vetëdijshëm për këtë.

- Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e AK-ve theksuan se SPE-ja ka përmirësuar profesionalizmin në kryerjen e procedurave të prokurimit dhe ka ndikuar në përmirësimin e reputacionit të institucioneve publike që administrojnë procedurat e prokurimit.
- Sipas përfaqësuesve të AK-ve, në përgjithësi, numri i procedurave të prokurimit të anuluar në 2009 ishte pothuajse i njëjtë ose është ulur në krahasim me 2008. Ata nuk besojnë se anulimet kanë ardhur për shkak të problemeve që lidhen me SPE-në. Në shumicën e rasteve, ofertuesit janë skualifikuar për shkak se dokumentet e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e procedurës të prokurimit. Kjo çon në anulim të procedurës për shkak të numrit të pamjaftueshëm të ofertuesve të kualifikuar për këtë procedurë prokurimi, sepse me ligj, një procedurë prokurimi është e suksesshme kur ka të paktën dy ofertues të kualifikuar.
- Në disa rajone, për shkak të pamjaftueshmërisë së infrastrukturës kompjuterike dhe të shërbimeve të teknologjisë së informacionit (IT), si kompjutera me parametrat e duhur dhe internet të shpejtë, komunat, bashkitë dhe AK të tjera lokale i kanë kryer procedurat e prokurimit elektronik duke shfrytëzuar salla të ngritura enkas për këtë punë nga Këshilli i Qarkut përkatës.
- Cilësia e shërbimeve të internetit nuk është e njëjtë në të gjitha rrethet e vendit, pasi kjo varet kryesisht nga kompanitë private që ofrojnë internet. Në rastet kur kanë hasur probleme me lidhjen e internetit, specialistë në AK-të e intervistuar kanë përdorur internet kafe dhe kanë punuar pas orarit të punës për të përfunduar procedurën përkatëse të prokurimit.
- Ndërkohë që SPE-ja ka bërë të mundur për ofertuesit nga i gjithë vendi dhe, në disa raste, edhe për kompanitë e huaja, që të paraqesin oferta për çdo procedurë prokurimi, gati gjysma e OE-ve që paraqitën oferta për AK-të e intervistuar, nodohen në të njëjtin rajon me AK-në që administron procedurën përkatëse të prokurimit.
- Megjithëse APP-ja dhe MCCA1 kanë bërë të mundur trajnime të mjaftueshme mbi SPE-në për AK-të, ka ende nevojë për trajnime të mëtejshme mbi përdorimin e sistemit, sidomos për anëtarët e KVO-ve. Fakti që SPE-ja ndryshon vazhdimisht është një arsye tjetër për të organizuar trajnime të vazhdueshme, sepse ka nevojë të njihen këto ndryshime.
- Të gjithë të intervistuarit thanë se ata kanë kërkuar ndihmën e APP-së kur kanë hasur probleme gjatë përdorimit të SPE-së. Megjithatë, komunikimi në kohë reale me APP është shpesh i vështirë, sepse APP-ja ka vënë në dispozicion vetëm një numër telefoni për të gjithë AK-të në vend.
- Vetëm disa prej AK-ve të intervistuar e përdorin SPE-në për të komunikuar me OE-të përmes menisë “Kërkesat e mia” të SPE-së gjatë procesit të prokurimit, sepse ata e kanë të vështirë ta përdorin atë. AK-të përdorin kryesisht funksionin e mesazheve elektronik (në menunë “Mesazh”). Ky funksion i SPE-së është shumë i rëndësishëm për komunikimin elektronik midis AK-ve dhe OE-ve, por nuk është përdorur shpesh nga të dyja palët.
- Disa zyrtarë të AK-ve thanë se për ta mjafton komunikimi me OE-të nëpërmjet letrave zyrtare ose takimet me ta personalisht kur OE-të shkojnë në zyrat e AK-së.
- Anëtarët e KVO-ve vazhdojnë të mbajnë procesverbale me shkrim për vendimet e marra gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave, në rast se AK-ja përkatëse ka nevojë për sqarim ose informacion shtesë mbi dokumentet e ofertave të paraqitura.
- Gati të gjithë të intervistuarit thanë se ata nuk kanë probleme në përdorimin e SPE-së për të menaxhuar një procedurë prokurimi, por ka ende disa barrierë në komunikimin me OE-të nëpërmjet SPE-së.

2. Metodologjia

Studimi i SPE-së është kryer nëpërmjet: (i) intervistave të drejtpërdrejta me 300 OE në 12 rrethe të Shqipërisë, (ii) 21 intervistave në thellësi me specialistë të prokurimit dhe anëtarë të komisioneve të vlerësimit të ofertave nga AK në gjashtë rrethe dhe (iii) dy fokus grupe me specialistë të prokurimit ose anëtarë të KVO-ve të AK-ve të zgjedhura. Fillimisht, ishte e vështirë për AmCham për të gjeneruar listën e plotë të OE-ve dhe AK-ve përmes SPE-së dhe shpesh të dhënat e kontaktit të OE-ve në bazën e të dhënave të SPE-së nuk ishin të përditësuara.

a. Vrojtimi i OE-ve. Shembulli për studimin e OE-ve është bazuar në listën e të gjitha OE-ve të regjistruara në SPE, të cilat kanë paraqitur të paktën një herë një ofertë përmes SPE-së gjatë vitit 2009. Në studim u përfshinë biznese në 12 rrethe të Shqipërisë: Tiranë, Durrës, Fier, Korçë, Elbasan, Berat, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, dhe Gjirokastrë. Shembulli përfaqësues përbëhej nga 300 OE të zgjedhura rastësisht, të shpërndara në mënyrë proporcionale në bazë të përqindjes së numrit të këtyre OE-ve në çdo rreth në raport me numrin total të 1755 OE-ve. U përgatit, gjithashtu, edhe një listë rezervë për të zëvendësuar bizneset që mund të refuzonin të merrnin pjesë në vrojtim, ose bizneset që nuk mund të gjendeshin.

Vrojtimi u realizua nëpërmjet intervistave të drejtpërdrejta me OE-të. Personi i intervistuar ishte direkt përgjegjës për procedurat e prokurimit në kompani. Instrumenti i studimit ishte një pyetësor standard i përgatitur nga AmCham me ndihmën edhe të MCCA2. Pyetjet u grupuan në katër seksione dhe kishin për qëllim mbledhjen e të dhënave mbi përvojën e biznesit në përdorimin e SPE-së, duke basur si bazë procedurën e fundit të prokurimit, në të cilën biznesi i intervistuar kishte marrë pjesë, si dhe perceptimin e përgjithshëm dhe idetë e tyre lidhur me SPE-në.

b. Vrojtimi i AK-ve. Përvoja e AK-ve me SPE-në u studiuva përmes intervistave në thellësi me 13 specialistë të prokurimit dhe 8 anëtarë të KVO-ve në gjashtë rrethe, pra 21 intervista gjithsej. AmCham intervistoi gjashtë specialistë të tillë në Tiranë dhe tre në secilin nga pesë rrethet e tjera: Shkodër, Fier, Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë. AK-të e intervistuar përfshinin institucione qendrore, njësi të qeverisjes lokale, si dhe ndërmarrje publike (sh.a.). AmCham përdori listën e të gjithë AK-ve të botuar në faqen e internetit të APP-së për periudhën janar-dhjetor 2009 për të zgjedhur AK-të që do të intervistoheshin. Përveç kësaj, AmCham organizoi dy fokus grupe me AK-të në rrethet e Elbasanit dhe Vlorës.

AmCham përgatiti një udhëzues për intervistat në thellësi dhe njëkohësisht udhëzuesin për drejtimin e fokus grupeve. Çështjet në këta udhëzues u grupuan në tema me qëllim që të prekeshin të gjitha aspektet e përdorimit të SPE-së gjatë gjithë fazave të një procedure prokurimi.

3. Gjetjet nga vrojtimi i Operatorëve Ekonomikë

Prezantimi i rezultateve

Rezultatet e paraqitura më poshtë janë kryesisht në formën e frekuencave dhe kryqëzimit të vlerave. Variablat kryesore të përdorur për kryqëzimin e vlerave janë: (a) *vendndodhja e biznesit* - bizneset janë ndarë në dy grupe: “*në Tiranë*”, që përfshin biznese të vendosura në rrethin e Tiranës, dhe “*jo në Tiranë*”, i cili përfshin biznese të vendosura në pjesën tjetër të rretheve të përzgjedhura; (b) *xhiroja vjetore e kompanisë*, dhe (c) *pjesëmarrja në trajnime formale mbi SPE-në*.


Në çdo grafik është shënuar numri i përgjithshëm i përgjigjeve. Përqindjet janë rrumbullakuar në numrin e plotë më të afërt. Marzhi i gabimit për një shembull të madhësisë 300 është 5,2%, me interval besimi 95%. Për disa pyetje, madhësia e shembullit ishte më e vogël (e cilësuar aty ku duhet), kështu që marzhi i gabimit është më i lartë.

Shpërndarja gjeografike e shembullit është si më poshtë:

Tabela 1. Shpërndarja e shembullit sipas rretheve


Rrethi	Numri i të intervistuarve	Përqindja e shembullit
Berat	13	4
Dibër	7	2
Durrës	17	6
Elbasan	23	8
Fier	29	10
Gjirokastra	9	3
Korça	18	6
Kukës	10	3
Lezha	6	2
Shkodra	19	6
Tirana	132	44
Vlora	17	6
Total	300	100

Grafiku 1: Shpërndarja e shembullit sipas formës ligjore të shoqërisë (n = 300)




Shumica e OE-ve të intervistuar (83%) janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa 13% janë persona fizikë. Shoqëritë aksionare përfaqësojnë vetëm 4% të shembullit.

Grafiku 2: Shpërndarja e shembullit sipas veprimtarisë kryesore të biznesit (n = 300)




Shembulli ka një shpërndarje të larmishme bazuar në sektorin kryesor të aktivitetit të kompanisë. Bizneset e intervistuar janë kryesisht të përfshira në tregti (32%), shërbime (28%) ose ndërtim (27%).

Grafiku 3: Shpërndarja e shembullit sipas numrit të të punësuarve (n = 300)




95% e bizneseve që marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik, janë të klasifikuara si ndërmarrje të vogla apo të mesme, sepse punësojnë më pak se 80 punëtorë, ndërsa vetëm 5% kanë më shumë se 80 të punësuar. Një total prej 40% e bizneseve të intervistuar kanë 5 ose më pak të punësuar (në këtë grup janë përfshirë edhe të vetë-punësuarit).

Grafiku 4: Xhiroja vjetore e kompanisë (n = 300)



Shembulli përfshin një gamë të plotë të bizneseve për sa i përket xhiros vjetore. Bizneset me xhiro vjetore 5 milionë lekë ose më pak përbëjnë 18% të shembullit.


Grafiku 5: Përqindja e xhiros vjetore të kompanisë nga prokurimet publike (n = 300)



Pak më shumë se gjysma e të intervistuarve thanë se 25% ose më pak e xhiros së tyre vjetore vjen nga prokurimet publike. Përafërsisht 28% e bizneseve të anketuara nxjerrin të paktën gjysmën e xhiros së tyre vjetore nga prokurimet publike.


Pjesa në vijim fokusohet në kapacitetet njerëzore dhe të teknologjisë së informacionit të OE-ve. Të intervistuarit u pyetën në lidhje me trajnimin mbi përdorimin e SPE-së dhe të infrastrukturës së nevojshme (komputera dhe akses në internet) për të përfunduar një procedurë prokurimi.

Grafiku 6: Pjesëmarrja në trajnimet për SPE-së – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’




Përafërsisht, 28% e të intervistuarve thanë se kishin marrë pjesë në një trajnim formal mbi përdorimin e SPE-së gjatë vitit 2009. Rezultatet ndryshonin vetëm pak mes bizneseve në Tiranë dhe atyre jashtë Tiranës.

Grafiku 7: Pjesëmarrja në trajnimin për SPE-në kundrejt nevojës për trajnime të mëtejshme (n = 300)




47% e të intervistuarve që tashmë kanë marrë trajnim, në krahasim me 57% e atyre që nuk janë trajnuar, thanë se ka nevojë për trajnime të mëtejshme rreth përdorimit të SPE-së.

Grafiku 8: Parametrat e kompjuterave dhe kapaciteti për të përdorur SPE-në (n = 300)




Bizneset që kanë marrë pjesë në prokurime elektronike thanë, përgjithësisht, se kanë kapacite dhe pajisje të përshtatshme për të kryer procedurën e prokurimit përmes internetit. Kur u pyetën për kapacitetin dhe parametrat e kompjuterave që ata përdorin për të ndërvepruar me SPE-në, 90% e të intervistuarve, të cilët ishin personat përgjegjës për pjesëmarrjen e kompanisë përkatëse në procedura prokurimi, i vlerësuan ato si “shumë të mira” apo “të mira”.

Grafiku 9: Llojet e lidhjes me internetin (n = 296)




72% e bizneseve të intervistuar kanë lidhje interneti ADSL.

Grafiku 10: Shpejtësia e ulët e internetit si një problem – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’




Grafiku 11: Ndërprerjet e shumta si një problem – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’



Siç shihet në grafikët 10 dhe 11 më lart, bizneset jashtë Tiranës hasin shumë më shpesh probleme në përdorimin e internetit – shpejtësi të ulët të lidhjes dhe ndërprerje – kur krahasohen me bizneset në Tiranë.


Grafiku 12: Vendet ku OE-të përdorin SPE-në – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’



Bizneset u pyetën për vendin që shfrytëzojnë për të përdorur SPE-në. 91% e bizneseve në Tiranë dhe 77% e atyre jashtë Tiranës e përdorin SPE-në në zyrat e tyre. Është interesante se 11% e bizneseve të intervistuar jashtë Tiranës shfrytëzojnë palë të treta që ofrojnë shërbim për të kryer një procedurë prokurimi në SPE. Gjithashtu, 8% e bizneseve jashtë Tiranës dhe 4% e bizneseve të Tiranës shfrytëzojnë internet kafetë për të përdorur SPE-në.


Një objektivi i rëndësishëm i këtij vrojtimi ishte vlerësimi i përvojës së përgjithshme të OE-ve në përdorimin e SPE-së gjatë vitit 2009. Ky ishte viti i parë kur të gjitha procedurat e prokurimit publik u zhvilluan përmes SPE-së.

Grafiku 13: Procedura e parë e prokurimit e dorëzuar përmes SPE-së (n = 300) (përqindje kumulative)




34% e bizneseve të intervistuar thënë se filluan ta përdorin SPE-në në vitin 2008. Pjesa tjetër e paraqitën ofertën e parë përmes SPE-së në vitin 2009, shumica e tyre gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

Grafiku 14: Procedura e parë e prokurimit e dorëzuar përmes SPE-së – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’




Një numër më i madh i OE-ve në Tiranë (48%) paraqitën ofertën e parë përmes SPE-së në vitin 2008 në krahasim me bizneset jashtë Tiranës (23%). 72% e OE-ve jashtë Tiranës paraqitën ofertën e tyre të parë përmes SPE-së në periudhën janar-qershor 2009, kur prokurimi elektronik u bë i detyrueshëm.

Grafiku 15: Ku i keni paraqitur shumicën e ofertave gjatë vitit 2009? (n=300)




Vetëm 18% e bizneseve të intervistuar kanë paraqitur oferta në AK që gjenden pranë ose larg vendndodhjes së OE-së. Gjysma e OE-ve të mbetura (41%) kanë paraqitur oferta kryesisht në AK-të që gjenden në Tiranë dhe gjysma tjetër kryesisht në AK-të që gjenden në rajone të tjera.

Grafiku 16: Ku i keni paraqitur shumicën e ofertave gjatë vitit 2009? – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’.




Vetëm një përqindje e vogël e OE-ve kanë paraqitur pjesën më të madhe të ofertave tek AK në rajone të tjera nga ku ndodhen ata vetë. 78% e të intervistuarve në Tiranë dhe 73% e atyre jashtë Tiranës thanë se i kishin paraqitur shumicën e ofertave të tyre tek AK-të në apo afër vendndodhjes së kompanisë së tyre.

Grafiku 17: Numri i ofertave të paraqitura në vitin 2009 (n = 300)




35% e bizneseve të intervistuar kanë dorëzuar oferta për 9 ose më shumë procedura prokurimi gjatë vitit 2009. 39% e OE-ve dorëzuan oferta për 3 ose më pak procedura prokurimi.

Grafiku 18: Xhiroja vjetore e kompanisë kundrejt pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit gjatë vitit 2009 (n=278)




Bizneset më të mëdha kanë tendencë të marrin pjesë në më shumë tendera. Gjysma e OE-ve të intervistuar që kanë një xhiro vjetore prej më shumë se 100 milion lekë, kanë marrë pjesë në 9 ose më shumë procedura prokurimi në 2009, ndërsa 74% e bizneseve të intervistuar me qarkullim vjetor prej 5 milion lekë ose më pak kanë dorëzuar tre ose më pak oferta në 2009.

Grafiku 19: Aksesi i kompanisë në njoftimet dhe DST-të në krahasim me sistemin e prokurimit në letër – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’




Shumica e të dy grupeve, bizneset që ndodhen jashtë Tiranës (58%) dhe ato me bazë në Tiranë (57%), deklaruan se SPE-ja ka rritur aksesin e tyre në njoftimet e tenderit dhe dokumentet standarde të tenderit (DST). Një pjesë e vogël e të dy grupeve (respektivisht, 12% dhe 7%) thanë se, me hyrjen në përdorim të SPE-së, ka rënë aksesi i tyre në procedurat e prokurimit në 2009.

Grafiku 20: Pjesëmarrja e OE-ve në procedurat e prokurimit në krahasim me sistemin e prokurimit në letër (n = 300)




Siç tregohet në grafikun 20 më lart, 70% e të intervistuarve thanë se përdorimi i SPE-së ka rritur numrin e procedurave të prokurimit, për të cilat ata paraqitën oferta në 2009, në krahasim me sistemin e prokurimit në letër. Sipas grafikut 21 më poshtë, kjo nuk lidhet me madhësinë e ndërmarrjes.

Grafiku 21: Xhiroja vjetore e kompanisë kundrejt pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi nëpërmjet SPE-së në krahasim me sistemin e prokurimit në letër (n = 287)




Grafiku 22: Shpeshtësia e kontakteve me specialistët e prokurimit të AK-ve (n = 300)



Përdorimi i SPE-së ka zvogëluar numrin e kontakteve personale të drejtpërdrejta të OE-ve me AK-të. 71% e bizneseve të intervistuar thënë se ata komunikojnë vetëm përmes SPE-së me specialistët përkatës të prokurimit në AK-të, në të cilat ata kanë paraqitur oferta. Vetëm 7% e OE-ve të anketuara ende mbështeten në kontakte personale me AK-të.

Grafiku 23: Marrja e informacionit gjatë një procedure prokurimi (përgjigje e shumëfishtë)




OE-të u pyetën se si marrin informacion gjatë çdo faze të procedurës së prokurimit. Të anketuarit thanë se ata marrin informata kryesisht nëpërmjet SPE-së. Përqindjet variojnë sipas llojit të njoftimit, me përdorimin më të lartë të SPE-së për njoftimet e kualifikimit (83%) dhe përdorim më të ulët për marrjen e informacionit mbi hapjen e ofertave (56%).

20% e të intervistuarve thanë se Buletini i Prokurimeve të APP-së vazhdon të mbetet një burim i mirë informacioni për gjetjen e njoftimeve të tenderave.

Megjithatë, OE-të vazhdojnë të mbajnë ende kontakte personale me zyrtarët e prokurimeve në AK në disa raste. 36% e bizneseve të intervistuarra thanë se ata e marrin në telefon ose takohen personalisht me zyrtarin e prokurimit, kur kanë nevojë për informacion mbi hapjen e ofertave. 20% e të intervistuarve thanë se ata e bëjnë këtë gjë kur kanë pyetje apo duan përgjigje rreth dokumentave standarde të tenderit.


Të intervistuarve iu kërkua të vlerësonin se sa i lehtë ishte përdorimi i SPE-së, bazuar në përvojën e tyre të fundit me një procedurë prokurimi. Përgjigjet e tyre janë përmbledhur në grafikët 24-26.

Grafiku 24: Gjetja e njoftimit të tenderit dhe DST-ve (n = 300)




Gjetja e njoftimit të tenderit dhe i DST-ve, si dhe ngarkimi i dokumentave të ofertës janë dy nga fazat më të rëndësishme në një procedurë prokurimi. Shumica e bizneseve të intervistuar (90%) thanë se ishte “e lehtë” ose “shumë e lehtë” për të gjetur njoftimet për tender dhe DST-të në SPE.

Grafiku 25: Sa i lehtë është ngarkimi i dokumentave të ofertës? (n=300)




Në kontrast me përgjigjen më lart, 48% e bizneseve të intervistuar thanë se është “shumë vështirë” ose “vështirë” të ngarkohen dokumentet e ofertës. Përqindjet janë pothuajse të njëjta për bizneset në Tiranë dhe për ato jashtë Tiranës.

Grafiku 26: Si e vlerësoni ndëreveprimin me SPE-në? (n=300)




Të pyetur se si e vlerësonin ndëreveprimin me SPE-në në faza të ndryshme të procedurës së fundit të prokurimit, ku kishin marrë pjesë, 76% e bizneseve të intervistuarat thanë se ndëreveprimi i përgjithshëm me SPE-në ishte “shumë i lehtë” ose “i lehtë”.

Grafiku 27: Pjesëmarrja në trajnime mbi SPE-në në raport me ndëreveprimin e përgjithshëm me SPE-në për të kryer një procedurë prokurimi (n = 299)




73% e OE-ve që nuk kanë marrë trajnim formal mbi SPE-në, thanë se është “shumë e lehtë” apo “e lehtë” për të ndërevepruar me SPE-në, ndërsa 85% e bizneseve që kanë marrë trajnim formal mbi përdorim e SPE-së thanë se është “shumë e lehtë” ose “e lehtë”.

Grafiku 28: Problemet gjatë përdorimit të SPE-së - përgjigje e shumëfishtë (n = 629)




Të anketuarit përmendën *ngarkimin e dokumentave pas orarit të punës (72%), faqen e internetit të APP-së që nuk punon (58%) dhe kohën e gjatë për të ngarkuar dokumentat (42%)* si problemet kryesore, me të cilat ishin ballafaquar në përdorimin e SPE-së.

Grafiku 29: Koha e shpenzuar për të përfunduar një procedurë prokurimi (n = 300)




Për shumicën e të intervistuarve, *kërkimi për njoftimet e tenderit dhe ngarkimi i dokumenteve të ofertës mund të bëhet brenda një ditë pune ose më shpejt*. Megjithatë, dy të tretat e të anketuarve thanë se *përgatitja e dokumenteteve të ofertës në formatin e kërkuar* kërkon më shumë se një ditë. 12% thanë se kjo kërkon më shumë se 5 ditë.

Grafiku 30: Kostot e burimeve njerëzore dhe financiare për të përfunduar një procedurë prokurimi nëpërmjet SPE-së në krahasim me sistemin e prokurimit në letër (n = 246)




82% e OE-ve të intervistuar thënë se kostot (njerëzore dhe financiare) e pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi përmes SPE-së janë reduktuar në krahasim me sistemin e prokurimit në letër.

Grafiku 31: Reduktimi i kostove për të përfunduar procedurën e prokurimit përmes SPE-së në krahasim me sistemin e prokurimit në letër – ‘në Tiranë’ kundrejt ‘jo në Tiranë’.



Ndër bizneset që thanë se kostot ishin reduktuar falë përdorimit të SPE-së, një total prej 62% e bizneseve në Tiranë thanë se shpenzimet e tyre ishte zvogëluar me të paktën 25%, kundrejt 49% e bizneseve jashtë Tiranës që thanë të njëjtën gjë.


Grafiku 32: Niveli i besimit në SPE (n = 300)



Bizneseve iu kërkua të shprehin sa besim kanë në disa aspekte të rëndësishme të SPE-së. Të dhënat tregojnë se OE-të e intervistuarat kanë shumë besim tek SPE.


Besimi në përgjithësi në sistem arrin në 92% (“shumë besim” ose “kam deri diku besim”). 92% e të anketuarve kanë “shumë besim” ose “kanë deri diku besim” se *dokumentet e paraqitura nuk mund të ndryshohen kur janë në sistem*. Disa biznese (18%) nuk janë të bindura se *oferta e tyre financiare nuk është komprometuar paraprakisht* (para hapjes së ofertave).

Grafiku 33: Besimi i përgjithshëm në SPE - sipas numrit të ofertave të paraqitura



Besimi i përgjithshëm në SPE rritet në varësi të rritjes së pjesëmarrjes në tendera përmes SPE-së. Ndërsa 15% e bizneseve të intervistuar që kanë marrë pjesë në tre ose më pak tendera gjatë vitit 2009, thanë se nuk kanë besim në SPE, vetëm 5% e bizneseve që kanë ofertuar në të paktën 9 tendera, thanë se nuk kanë besim tek ky sistem.

Grafiku 34: Si do t’i vlerësonit këto aspekte të SPE-së? (n=300)



Rezultatet e vrojtimit treguan një nivel në përgjithësi të lartë të kënaqësisë të OE-ve me SPE-në në të gjithë treguesit. Shumica e përgjigjeve janë në kategorinë “mirë”, e ndjekur nga “kënaqshëm” dhe “shumë mirë”. Vetëm 7% e të anketuarve i vlerësojnë kapacitetin dhe përgjithshme dhe karakteristikat e sistemit si “jo kënaqshëm”. Përqindja më e madhe e përgjigjeve “jo kënaqshëm” (15%) është për cilësinë dhe kohën e dhënies së informacionit nga specialistët e prokurimit në AK.

4. Gjetjet nga vrojtimi i autoriteteve kontraktore

Gjetjet nga intervistat në thellësi dhe fokus grupet me AK-të janë paraqitur më poshtë si një përmbledhje e opinionëve, interpretimeve dhe rekomandimeve që përfaqësuesit e AK-ve dhanë gjatë intervistave të drejtpërdrejta me ta.

1. Përdorimi i SPE-së

Specialistët e prokurimit të AK-ve dhe anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave (KVO), të cilët i intervistoi AmCham, kishin përvojë me procedurat e prokurimit, i njihnin mirë të dy llojet e procedurave të prokurimit (atë në letër dhe atë elektronike) dhe kishin përdorur ekskluzivisht SPE-në në 2009-n. Shumë prej tyre ishin angazhuar seriozisht në përdorimin e SPE-së vetëm kur kjo u bë e detyrueshme. Por, disa institucione kishin filluar ta përdornin SPE-në që në 2008, kur ky sistem u vu në funksionim.

Numri i procedurave të prokurimit të kryera nga secili AK që kur filluan ta përdornin SPE-në, varion në varësi të buxhetit të tyre: nga dy ose katër procedura të prokurimit elektronik deri në 35 apo 37 procedura.

Specialistët e AK-ve theksuan se ka pasur shumë raste kur edhe kompani të huaja kanë dorëzuar oferta për procedura të caktuara prokurimi.

Gjatë muajve të parë të vitit 2009, kur përdorimi i SPE-së u bë i detyrueshëm, jo të gjithë AK-të dhe OE-të kishin njohuri apo specializimin e mjaftueshëm për ta përdorur SPE-në. Ka pasur raste kur OE-të kanë kërkuar ndihmë teknike nga njësia e prokurimit e AK-së, tek e cila donin të dërgoni një ofertë. Përfaqësuesit e AK-ve thanë se, në disa raste, OE-të kanë paguar konsulentë që t'i ndihmojnë për të përdorur SPE-në.

Shumica e të intervistuarve vuri në dukje se, megjithëse pati një fillim të vështirë për të dyja palët, OE-të janë tani të sigurtë në përdorimin e sistemit dhe për shumicën e procedurave, dokumentet e ngarkuara në sistem janë në formatin e kërkuar. Numri mesatar i OE-ve që marrin pjesë në procedurat e prokurimit elektronik, është pak a shumë i njëjtë në të gjitha AK-të që u intervistuan: rreth 6-8 OE për secilën procedurë prokurimi elektronik. AK-të e konsiderojnë të pranueshëm këtë numër ofertuesish.

Gjysma e OE-ve që paraqitën oferta në AK-të e intervistuar, ndodhen në të njëjtin rajon me AK-në që i administrojnë procedurat përkatëse të prokurimit, ndërsa OE-të e tjera janë nga pjesët e tjera të vendit. Në shumë prej procedurave të prokurimit elektronik me fonde të konsiderueshme ose kur OE-të lokale nuk mund të ofrojnë punë apo mallra specifike, ofertat vijnë nga OE-të me qendër në Tiranë ose në rajonet të tjera. AK-të thanë se futja e SPE-së ka rritur pjesëmarrjen e OE-ve në nivel kombëtar, duke bërë që, për shembull, OE-të nga Kukësi të konkurrojnë për një procedurë prokurimi në Gjirokastrë dhe anasjelltas.

Numri i procedurave të prokurimit që anulohen ka mbetur në përgjithësi i pandryshuar ose është ulur në krahasim me 2008. Të intervistuarit dhe pjesëmarrësit në fokus grupe thanë se të gjitha procedurat e prokurimi që janë anuluar, janë përsëritur dhe kanë përfunduar me sukses në një datë të mëvonshme.

Çështja e anulimit të procedurave elektronike është një shqetësim i vazhdueshëm për AK-të, pasi kjo çon në përsëritjen e punës, në humbje kohe dhe në vonesa në përdorimin e fondeve buxhetore, duke çuar, për rrjedhojë, në mungesën e mallrave ose shërbimeve që i nevojiten institucionit publik përkatës. Përfaqësuesit e AK-ve të intervistuar thanë se anulimet nuk ndodhnin për shkak të problemeve të SPE-së, por ato lidheshin me OE-të që kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit që anulohet. Sipas të intervistuarve, e vetmja arsye për anulimin e procedurave të prokurimit është se dokumentet e paraqitura nga OE-të nuk i përbushin kriteret e kërkuara nga tenderi.

Në këto situata, kur nuk ka të paktën dy OE që kualifikohen, në bazë të Ligjit nr. 9643 “Për Prokurimin Publik”, të datës 20 nëntor 2006, procedura e prokurimit anulohet për shkak të mungesës së konkurrencës dhe ajo duhet të përsëritet nga fillimi. Nga ana tjetër, disa OE nuk i dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara nga AK-të, gjë që çon në skualifikimin e tyre.

Një tjetër shkak për anulimin e procedurave të prokurimit janë gabimet teknike nga specialistët e njësish të prokurimit gjatë përgatitjes së dokumenteve të procedurës së prokurimit, para se procedura të publikohet në SPE. AK-të mund t’i korrigjojnë gabimet në dokumentet e procedurës së prokurimit deri në momentin kur këto dokumente nuk janë ngarkuar në SPE. Pasi dokumentet e procedurave të prokurimit ngarkohen në SPE, AK-të mund të anulohen procedurën, por nuk mund t’i korrigjojnë dokumentet.

Në disa raste, procedurat e prokurimit janë anuluar edhe për shkak se nuk ishin paraqitur oferta.

II. Kapacitetet e autoriteteve kontraktore (infrastrukturë dhe burime njerëzore)

Kur prokurimi elektronik u bë i detyrueshëm që nga 1 janari 2009, AK-të morën masat e nevojshme që të kishin kompjuterat dhe lidhje në internet të nevojshme për ta përdorur SPE-në. Rreth gjysma e të intervistuarve thanë se AK-ja e tyre kishte vetëm tre kompjutera në dispozicion për njësinë e prokurimit dhe anëtarët e KVO-ve. Duhet të theksohet se, në disa rajone, të vetëdijshëm për vështirësitë, më të cilat përballen komunat dhe autoritetet e tjera kontraktore lokale (të cilat nuk mund t’i plotësonin plotësisht kërkesat teknike për përdorimin e SPE-së), Këshilli i Qarkut përkatës ka ngritur një sallë me kompjutera dhe internet në godinën e tij. Çdo autoritet kontraktor në atë rajon mund ta përdorë këtë sallë për të administruar procedurat e prokurimit elektronike.

Disa AK kanë caktuar një sallë të pajisur me kompjutera dhe lidhje interneti që specialistët e prokurimit dhe anëtarët e KVO mund ta shfrytëzojnë për të përdorur SPE-në. Anëtarët e KVO-ve, me ndihmën e specialistëve të njësish të prokurimit, shpesh kanë nevojë për t’u takuar dhe për të diskutuar ofertat e paraqitura nga OE-të. Disa prej AK-ve kanë vënë në dispozicion një zyrë të veçantë të dedikuar për këto takime, zyrë e cila ka kompjutera shtesë dhe lidhje interneti. Anëtarët e KVO-ve i shfrytëzojnë këto zyra për të bërë mbledhje dhe për të përdorur SPE-në. Kjo i ndihmon shumë anëtarët e KVO-ve, për shkak se procesi i vlerësimit të ofertave zhvillohet shpejt dhe në kohë reale.

Të intervistuarit thanë se AK-të e tyre përdorin kompjutera që kanë parametra shumë të mirë teknike për të përdorur SPE-në: ata lejojnë ngarkimin dhe shkarkimin me lehtësi të

dokumente dhe janë të pajisur me programet kompjuterike të nevojshme për të punuar me dokumenta të formateve të ndryshme. Pothuajse të gjitha AK-të kanë lidhje ADSL në internet. Në disa raste, ata kanë dy linja ADSL me shpejtësi normale për t'u siguruar që kanë lidhje të vazhdueshme interneti.

Për shkak të afateve të procedurave të prokurimit, kur ka probleme, specialistë në AK-të e intervistuar nuk mund të presin të përmirësohet shërbimi i internetit, por ata duhet të gjejnë zgjidhje të tjera për të vazhduar punën. Ka pasur shumë raste, kur specialistë të prokurimit ose anëtarë të KVO-ve kanë shkuar në internet kafe ose në institucione të tjera për të përfunduar një procedurë prokurimi ose ju është dashur të punojnë pas orarit zyrtar. Shërbimi i internetit nuk është i njëjtë në të gjitha rrethet e vendit, pasi kjo varet nga kompanitë private (Internet Service Providers-ISP), që e ofrojnë këtë shërbim në zona të ndryshme.

Departamentet e Teknologjisë së Informacionit (IT) në disa AK kishin kapacitete dhe aftësi financiare për të krijuar një rrjet të brendshëm elektronik (intranet) në institucion. Ky rrjet është përdorur rregullisht për të përgatitur procedurat e prokurimit dhe kjo i ka ndihmuar anëtarët e KVO-së dhe njësinë e prokurimit për ta përfunduar punën. Megjithatë, jo çdo AK ka njohuritë e nevojshme për të zhvilluar një intranet. Disa nga AK-të që nuk kanë intranet, nuk e dinin se ç'është ky rrjet dhe se si mund të përdoret në punën e tyre të përditshme.

Të gjithë të intervistuarit ishin trajnuar lidhur me përdorimin e SPE-së nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP), mbështetur fillimisht nga faza e parë e Programit Prag të Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit për Shqipërinë MCCA1. Trajnimet u realizuan në fund të vitit 2008 dhe në fillim të 2009-ës. APP-ja i trajnoi specialistët e prokurimit dhe shpërnda materiale trajnimi, manuale përdorimi, si dhe një CD ilustruese mbi përdorimin e SPE-së. Trajnim mbi SPE-në është ofruar dhe financiar edhe nga Programi i Qeverisjes Vendore të USAID-it (LGPA) dhe organizata të biznesit, si AmCham.

Anëtarët e KVO-ve kanë nevojë për trajnime shtesë. Të gjithë të intervistuarit thanë se ata donin që trajnimi të vazhdojë. Jo të gjithë specialistët e AK-ve që punojnë me SPE-në, e njohin mirë këtë sistem. Fakti që SPE ndryshon vazhdimisht duke u përmirësuar, e thekson nevojën për trajnim të vazhdueshëm.

Të gjithë të intervistuarit thanë se, kur kanë pasur probleme me SPE-në, ata kanë kërkuar ndihmën e APP-së për t'i zgjidhur ato. Por AK-të kanë hasur probleme në përpjekjet për të komunikuar me APP-në. E vetmja mënyrë për të komunikuar në kohë reale me APP-në është me telefon dhe të intervistuarit u ankuan se APP-ja ka vënë në dispozicion vetëm një numër telefoni për të gjithë AK-të në vend. Kjo do të thotë se linja është shpesh e zënë.

AK-të e intervistuar kishin pasur disa probleme në përdorimin e SPE-së gjatë vitit 2009. Problemet më të shpeshta kanë qenë:

- Faqja e SPE-së nuk ka funksionuar mirë, duke shkaktuar ndërprerjen e ngarkimit të dokumenteve të prokurimit ose të procesit të publikimit të njoftimit për procedurën e prokurimit.
- Faqja e SPE-së nuk funksionoi si duhet disa herë gjatë vitit 2009 dhe shumë dokumente dhe procedura të prokurimit u fshinë, duke bërë që këto procedura të riniseshin nga e para dhe dokumentet e nevojshme të ngarkoheshin sërish nën drejtimin APP-së.

- APP-ja ndryshoi formatin për procedurat e prokurimit me lote dhe shtoi atë në SPE pa ofruar trajnim paraprak ose sqarime për AK-të. Kjo çoi në shumë probleme teknike që hasën AK-të, ndërsa përpiqeshin për të realizuar një procedurë me lote përmes SPE-së.
- Pati raste kur AK-të nuk mundën t'i ngarkonin DST-të në SPE dhe u detyruan të dërgonin një CD me DST-të tek APP-ja, në mënyrë që APP-ja t'i ngarkonte vetë këto dokumenta.
- AK-të kanë hasur probleme në rastet kur humbnin fjalëkalimin për llogarinë e tyre në SPE dhe tek përpiqeshin ta riaktivizonin atë në SPE. Në këto raste, AK-të kanë komunikuar me APP-në, specialistët e së cilës kanë ofruar një ndihmë efektive. Është e rëndësishme të theksohet se pothuajse 90 për qind e të intervistuarve thanë se, në këto raste, me ndihmën e APP-së, ata mundën ta përmbyllnin procedurën, për të cilin po punonin.

III. Komunikimi përmes SPE-së

Të intervistuarit thanë se ata nuk kanë vështirësi për të bërë të gjitha hapat gjatë procesit të përgatitjes së njoftimit të procedurave të prokurimit, si dhe gjatë vlerësimit të kualifikimeve të ofertuesve. Ata janë në gjendje t'i përfundojnë këto procese ose vetë, ose me ndihmën e një kolegu.

Shumë pak nga AK-të e intervistuar përdorin SPE për të komunikuar me OE-të gjatë procesit të prokurimit përmes menusë "Kërkesat e mia". Disa nga të intervistuarit thanë se ata nuk e dinin se mund të komunikojnë me OE-të përmes menusë "Kërkesat e mia". Ata komunikojnë me OE-të nëpërmjet letrave zyrtare apo takohen me ta kur këta të fundit shkojnë në zyrat e AK-ve. Disa AK e kanë të vështirë ta përdorin menunë "Kërkesat e mia" për të komunikuar me OE-të. Ato mendojnë se mjafton përdorimi i mesazheve elektronike ("Mesazh") përmes SPE-së. Nuk është shumë e qartë se si SPE-ja i kategorizon dhe administron kërkesat e OE-ve që vijnë në sistem përmes menusë "Kërkesat e mia", sepse është e paqartë se cilës AK i drejtohet një mesazh apo kërkesë e caktuar.

Në përgjithësi, AK-të komunikojnë me OE-të përmes SPE-së ose e përdorin SPE-në dhe komunikimin me letra zyrtare në të njëjtën kohë. Për të inkurajuar OE-të të përdorin SPE-në, në disa raste AK-të u dërgojnë një mesazh elektronik OE-ve me anë të SPE-së dhe, më pas, e njoftojnë OE-në përkatëse me telefon se i kanë dërguar një mesazh elektronik. AK-të përdorin të dyja metodat, "Mesazh" dhe "Kërkesat e mia", pavarësisht problemeve të hasura.

